

Në bazë të nenit 28 paragrafi (2), nenit 30 paragrafi (1) dhe nenit 45 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr.208/24 dhe 16/25), Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, në përbërje: M-r Borçe Razmoski–Kryetar, M-r Malinka Siljanovska Nikoliq, Aleksandar Trgaçevski, Nikola Trajčevski dhe Valon Elezi–anëtarë, duke vepruar sipas Kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse PK nr.09-43/1 të datës 21.12.2022 të paraqitur nga Shoqëria për tregti dhe prodhim AGRO-TREF SHPK me seli në rr. Udarnička nr.35 f. Dollni Podlog, Koçan kundër Ndërmarrjes Publike Komunale “Ujësjiellësi” me seli në rr. “Dr. Nikoliq” nr.64 Koçan, në seancën e mbajtur më 04.07.2025, solli këtë

AKTVENDIM

1.Konstatohet se Ndërmarrja Publike Komunale “Ujësjiellësi” me seli në rr. “Dr. Nikoliq” nr.64 Koçan, me NUAS: 4048393, NUT: 4013968102159, xhirollogaria nr. 300-0500000087-15 në Komercijalna Banka – Shkup dhe person i autorizuar – Mirçe Paunov, si ndërmarrje publike e themeluar me vendim të Këshillit të Komunës së Koçanit, e cila ka pozitë dominuese në tregun e furnizimit me ujë gjeotermal në territorin e Komunës së Koçanit, i ka dorëzuar Shoqërisë për tregti dhe prodhim AGRO-TREF SHPK Kontratë për furnizim me sasi uji gjeotermal nr.12-3571 të datës 18.10.2023, me të cilën kontratë ka futur një dispozitë kufizuese në nenin 3 paragrafi (3), që paraqet kundërvajtje sipas nenit 59 paragrafi (1) pika 2), në lidhje me nenin 11 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, me ç ‘rast i shqiptohet sanksion – gjobë në vlerë prej 10.000,00 denarësh, që paraqet 0,0040% të vlerës së të ardhurave vjetore të përgjithshme të Ndërmarrjes Publike Komunale “Ujësjiellësi” të realizuara në vitin 2024, si viti i fundit afarist për të cilin e njëjta ka hartuar llogari vjetore.

2.Gjobën nga pika 1) e këtij vendimi kundërvajtësit janë të detyruar ta paguajnë brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e formës së prerë të vendimit, në llogarinë transaksionale të përfituesit: 100-0000000630-95, llogaria e pagesës: 840xxx07337 – gjoba për kundërvajtje të kryera në fushën që është në kompetencë të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, me kod të të ardhurave 722139 dhe program 00, marrës i pagesës – Ministria e Financave, banka e përfituesit – BPRMV dhe te Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës të dorëzojë dëshmi/ekzemplar nga pagesa e kryer e gjobës brenda afatit prej 15 ditësh nga kryerja e pagesës. Gjobat e papaguara ose të paguara me vonesë do të mbliidhen me rrugë të detyrueshme. Padia e pezullon ekzekutimin e vendimit.

Arsyetim

Te Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: KVK) më 21.12.2022 nga ana e Shoqërisë për tregti dhe prodhim AGRO-TREF SHPK me seli në rr. Udarnička nr.35 f. Dollni Podlog, Koçan (në tekstin e mëtejme: AGRO-TREF SHPK) është paraqitur Kërkesë për fillimin e procedurës kundërvajtëse PK nr. 09-43/1 kundër Ndërmarrjes Publike Komunale “Ujësjiellësi” me seli në rr. “Dr. Nikoliq” nr.64 Koçan (në tekstin e mëtejme: NPK Ujësjiellësi Koçan) për shkak të konstatimit të kundërvajtjes sipas nenit 59 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës – abuzim i pozitës dominuese në kuptim të nenit 11 të këtij ligji.

Në kërkesë theksohet se NPK Ujësjiellësi Koçan, më 30.11.2022 i ka dorëzuar AGRO-TREF SHPK Kontratën për furnizim me sasi uji gjeotermal nr.12-3571 të datës 18.10.2023, me të cilën kontratë, përveç të drejtave dhe detyrimeve të tjera kontraktore, në nenin 3 paragrafi 3) të kontratës është parashikuar se nëse vjen deri te ndërprerja dhe shkëputja nga sistemi i furnizimit me energji elektrike për çfarëdo arsye të furnizuesi–dhënësi, ky nuk është përgjegjës për dëmin eventual të shkaktuar të përdoruesi dhe po ashtu theksohet se kjo është në kundërshtim me parimet e sigurisë në dhënien e shërbimeve, kontinuitetit të shërbimit, transparencës, disponueshmërisë dhe shërbimit universal, mbrojtjes së përdoruesve dhe konsumatorëve.

Më 22.12.2022 me e-mail të protokolluar me PK nr.09-26/2 nga ana e AGRO-TREF SHPK te KVK është dorëzuar Plotësim i Kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse PK nr. 09-43/1 të datës 21.12.2022 dhe me të janë dorëzuar shtojca me të cilat paraqitësi i kërkesës e mbështet kërkesën për fillim të procedurës kundërvajtëse, dhe ato: Vendim i Këshillit Drejtues të NPK Ujësjiellësi Koçan nr.02-381/2, Kontrata ndërmjet NPK Ujësjiellësi Koçan dhe AGRO-TREF SHPK e datës 30.11.2022 dhe pasqyrat e fundit financiare të publikuara të NPK Ujësjiellësi Koçan për tremujorin e tretë të vitit 2021.

Me e-mail të protokolluar me PK nr.09-26/1 më 26.04.2023, AGRO-TREF SHPK dorëzoi te KVK Plotësim të kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse të datës 22.12.20022.

Më 23.11.2023 me e-mail te KVK, e protokolluar me PK nr.09-26/2, AGRO-TREF SHPK dorëzoi plotësim të kërkesës për fillimin e procedurës kundërvajtëse. Në kërkesë AGRO-TREF SHPK thekson se NPK Ujësjiellësi Koçan sërish i ka dorëzuar AGRO-TREF SHPK të njëjtin formular cirkular si kontratë për sezonin e ngrohjes 2023/2024, me të njëjtat dispozita dhe çmime, duke shfrytëzuar pozitën e saj monopoliste në treg si i vetmi furnizues i mundshëm me energjent. Si shtojca të kësaj kërkesë AGRO-TREF SHPK dorëzoi te KVK: Shkresë e AGRO-TREF SHPK drejtuar Këshillit të Komunës së Koçanit, Raport për punën financiare të NPK Ujësjiellësi Koçan në periudhën 01.01 deri 31.03.2023, Raport për punën financiare të NPK Ujësjiellësi Koçan në periudhën 01.01 deri 31.12.2022, Statutin e NPK Ujësjiellësi Koçan nr.01-120/1 të datës 16.03.2020 dhe Kontratën për furnizim me ujë gjeotermal nr.12-357/1 të datës 18.10.2023.

Me e-mail PK nr.09-23/1 më 29.05.2024 AGRO-TREF SHPK dorëzoi te KVK Plotësim të urgjencës mbi kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse. Si shtojca të këtij plotësimi te KVK, AGRO-TREF SHPK dorëzoi: Kalkulim për përcaktimin e çmimit të ujit gjeotermal të datës 03.11.2022, Raport për punën financiare të NPK Ujësjiellësi Koçan në periudhën 01.01 deri 31.03.2023, Kalkulim për përcaktimin e çmimit të ujit gjeotermal të datës 23.09.2022 dhe Statutin e NPK Ujësjiellësi Koçan nr.01-120/1 të datës 16.03.2020.

Më 05.06.2024 me e-mail PK nr.09-23/2, AGRO-TREF SHPK dorëzoi te KVK Plotësim të urgjencës mbi Kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse, me të cilin AGRO-TREF SHPK dorëzon te KVK sqarime lidhur me kompensimet koncesionare dhe rregullimin e tyre, të cilat janë pjesë e çmimit të ujit gjeotermal.

Me e-mail të regjistruar me PK nr.09-23/3 më 05.06.2024, AGRO-TREF SHPK dorëzoi te KVK Plotësim të urgjencës mbi Kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse të datës 21.12.2022, me të cilin edhe një herë dorëzoi sqarime te KVK lidhur me rritjen e pajustifikuar të çmimit të ujit gjeotermal nga ana e NPK Ujësjiellësi Koçan.

Në seancën e mbajtur më 08.07.2024 KVK solli Konkluzion për fillimin e procedurës kundërvajtëse PK nr.08-23/8 kundër NPK Ujësjiellësi Koçan. Me Konkluzionin KVK detyroi NPK Ujësjiellësi Koçan të dorëzojë këto të dhëna dhe dokumente: bilancin e suksesit për vitin 2023, ekstrakt nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, të dhëna për xhirollogarinë, numrin e vetëm tatimor dhe bankën–depozituese të llogarisë dhe shprehje qëndrimi mbi kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse.

Konkluzioni është dorëzuar me shkresë përcjellëse nr. 09-23/9 të datës 08.07.2024.

Më 23.07.2024 me shkresë nr. 09-23/10 NPK Ujësjiellësi Koçan dorëzoi te KVK qëndrimin e tij mbi Konkluzionin për fillimin e procedurës kundërvajtëse PK nr.08-23/8.

Në përgjigjen mbi Konkluzionin, NPK Ujësjiellësi Koçan thekson se përdoruesi i shërbimeve, në rastin konkret AGRO-TREF SHPK, me nënshkrimin e kontratës ka dhënë deklaram vullneti për kushtet e kontratës së ofruar dhe është pajtuar me të njëjtat. Po ashtu në përgjigje theksohet se AGRO-TREF SHPK deri në ditën e skadimit të kontratës nuk ka dorëzuar asnjë vërejtje lidhur me atë, e veçanërisht jo për ekzekutimin e shërbimit nga ana e NPK Ujësjiellësi Koçan. I njëjti ka lidhur më pas edhe kontratë të dytë për të cilën gjithashtu nuk ka pasur vërejtje.

Në përgjigjen mbi Konkluzionin, NPK Ujësjiellësi Koçan thekson se kontratat me përdoruesit janë lidhur nën të njëjtat kushte, pa marrë parasysh nëse bëhet fjalë për institucione publike, ku përfshihen edhe shkollat, apo subjekte të tjera afariste, apo persona të caktuar fizikë që e përdorin shërbimin. Lidhur me dëmet e shkaktuara nga mosplotësimi i kontratës nga ana e NPK Ujësjiellësi Koçan, thuhet se asnjë përdorues nuk ka dorëzuar kërkesë apo njoftim për dëm të shkaktuar në bazë të mosplotësimit të kushteve të kontratës.

Më 14.03.2025 KVK solli Njoftim preliminar për gjendjen faktike të konstatuar PK nr.09-1/6 drejtuar NPK Ujësjiellësi Koçan.

Njoftimi përfundimtar për gjendjen faktike të konstatuar te NPK Ujësjiellësi Koçan është dorëzuar me shkresë përcjellëse PK nr.09-1/7 të datës 14.03.2025.

Më 07.04.2025 NPK Ujësjiellësi Koçan me Shkresë PK nr.09-1/9 dorëzoi përgjigje/qëndrim mbi njoftimin preliminar për gjendjen faktike të konstatuar të KVK-së.

Në këtë përgjigje theksohet se NPK Ujësjiellësi Koçan është ndërmarrje që është koncesionare në bazë të kontratës së koncesionit për shfrytëzimin e lëndës së parë minerale – ujit gjeotermal, të lidhur ndërmjet Qeverisë së RMV-së e përfaqësuar nga Ministri i Ekonomisë dhe NPK Ujësjiellësi Koçan. Për këtë shfrytëzim, si koncesionare, NPK Ujësjiellësi Koçan është e detyruar të paguajë kompensim për shfrytëzim, nën kushte të përcaktuara me Tarifën në fuqi për përcaktimin e lartësisë së kompensimeve për dhënie e lejeve dhe koncesioneve për shfrytëzimin e lëndëve të para minerale.

Me kontratën për furnizim me sasi uji gjeotermal nr.12-402/2 të datës 30.11.2022 të lidhur ndërmjet NPK Ujësjiellësi Koçan si dhënës dhe personit juridik AGRO-TREF SHPK si përdorues rregullohen mënyra dhe kushtet për furnizim me ujë gjeotermal, lidhja, ndërprerja, si dhe mënyra e llogaritjes dhe pagesës së ujit gjeotermal të furnizuar. Po ashtu me kontratën rregullohen edhe mënyra dhe kushtet për furnizim me ujë gjeotermal, lidhja, ndërprerja, si dhe mënyra e llogaritjes dhe pagesës së ujit gjeotermal të furnizuar.

Më 30.05.2025 KVK solli Njoftimin përfundimtar për gjendjen faktike të konstatuar PK nr.09-1/13 drejtuar NPK Ujësjiellësi Koçan.

Njoftimi përfundimtar për gjendjen faktike të konstatuar është dorëzuar te NPK Ujësjiellësi Koçan me shkrësë përcjellëse PK nr. 09-1/14 të datës 30.05.2025.

Më 18.06.2025 NPK Ujësjiellësi Koçan dorëzoi përgjigje mbi Njoftimin përfundimtar për gjendjen faktike të konstatuar. Në përgjigje theksohet se ata mbeten plotësisht pranë parashtrësive, pretendimeve dhe provave të deritanishme të dorëzuara te KVK, si dhe se kontratat e kontestuara për furnizim me ujë gjeotermal dhe anekset përkatëse janë përbushur në tërësi nga ana e NPK Ujësjiellësi Koçan. Dhënësi i shërbimit, në periudhën e kohëzgjatjes së kontratës, nuk ka marrë asnjë ankesë apo paraqitje dëmi për asnjë bazë nga ana e asnjë përdoruesi. Detyrimi nga kontrata për shërbimin e kryer është përbushur tërësisht dhe pa ndërprerje nga ana e NPK Ujësjiellësi Koçan. Gjithashtu, në përgjigjen mbi njoftimin përfundimtar, NPK Ujësjiellësi Koçan thekson se KVK gjatë konstatimit të gjendjes faktike dhe matjes së gjobës i ka marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese në lëndë, respektivisht dispozitën e kontestuar të Kontratës për furnizim me ujë gjeotermal dhe Anekset e dorëzuara të Kontratave, ku qartë figuron se dispozitat e nenit 3 paragrafi (3) janë fshirë nga NPK Ujësjiellësi Koçan dhe se në të ardhmen nuk do të kenë pasoja të dëmshme ndaj konsumatorëve.

Pas sigurimit të të dhënave të nevojshme me rëndësi për Vendimmarrje të drejtë në procedurën kundërvajtëse dhe nga provat e mbledhura në vend, si dhe nga qëndrimi mbi njoftimin preliminar dhe atë përfundimtar për gjendjen faktike të konstatuar të NPK Ujësjiellësi Koçan, KVK konstatoi se:

Sipas nenit 4 të Statutit të NPK UJËSJELLËSI Koçan:

“NPK UJËSJELLËSI është themeluar si organizatë pune komunale me vendim të Këshillit të Komunës së Koçanit nr. 01-1232 të datës 02.02.1968, ndërsa si ndërmarrje publike është themeluar me vendim të Këshillit të Komunës së Koçanit nr.08-5606/1 të datës 16.11.1989”.

Sipas nenit 2 të Statutit të NPK UJËSJELLËSI Koçan:

NPK UJËSJELLËSI Koçan është ndërmarrje e themeluar për kryerjen e veprimtarive me interes publik.

Veprimtari me interes publik janë veprimtaritë apo veprimet e veçanta nga veprimtaritë me të cilat realizohet interes publik.

NPK UJËSJELLËSI Koçan, në kuadër të fushës së saj të veprimtarisë, ndër veprimtaritë e tjera kryen edhe furnizim me ujë gjeotermal për konsumatorët/përdoruesit.

Ndërmarrja Publike Komunale “Ujësjiellësi” paraqet ndërmarrje që ka pozitë dominuese në tregun e furnizimit me ujë gjeotermal në territorin e Komunës së Koçanit, pasi nuk ekziston ndërmarrje tjetër që kryen të njëjtën veprimtari në territorin e Komunës së Koçanit, respektivisht që furnizon konsumatorët me ujë gjeotermal.

Duke marrë parasysh nenin 49 dhe nenin 50 të Statutit të NPK UJËSJELLËSI Koçan:

Në rast të dëmtimit të funksionimit, respektivisht kryerjes së veprimtarisë në NPK UJËSJELLËSI Koçan, nuk përmbushen detyrimet e përcaktuara me ligj, të cilat nuk janë pasojë e përmbushjes së detyrimeve nga ana e themeluesit të përcaktuara me aktin e themelimit, themeluesi mund të ndërmarrë masa me të cilat sigurohen kushte për funksionim të pandërprerë të ndërmarrjes NPK UJËSJELLËSI Koçan.

Dëmtimi i funksionimit të NPK UJËSJELLËSI Koçan do të konsiderohet se ka ndodhur:

Nëse me mënyrën e funksionimit **nuk sigurohet kryerje e qëndrueshme dhe pa pengesa e shërbimeve**, ose realizimi i planit të zhvillimit në mënyrën e përcaktuar me ligj, duke i shkaktuar dëm konsumatorëve.

Në rastin konkret, më 30.11.2022 NPK UJËSJELLËSI Koçan i ka lidhur Kontratë për furnizim me sasi uji gjeotermal me AGRO-TREF SHPK.

Sipas nenit 3 paragrafi (3) të Kontratës së lartpërmendur:

“Nëse vjen deri te ndërprerja dhe shkëputja nga sistemi i furnizimit me energji elektrike për çfarëdo arsye të furnizuesi–dhënësi, i njëjti nuk është përgjegjës për dëmin e shkaktuar te përdoruesi”.

Nënshtimi njëanshëm i çmimeve jo të drejta të blerjes dhe shitjes apo i kushteve të tjera jo të drejta tregtare, sipas Ligjit, paraqet në mënyrë të vetme abuzim me pozitën dominuese të ndaluar sipas nenit 11 të Ligjit.

Në nenin 58 të Ligjit parashikohet qartë se: **“Nëse shkaktohet dëm me çfarëdo veprimi që paraqet kundërvajtje në pajtim me dispozitat e këtij ligji, personi që pëson dëm mund të kërkojë kompensim në pajtim me ligjin”.**

Dispozita e tillë e nenit 3 paragrafi (3) të Kontratës për furnizim me sasi uji gjeotermal është në kundërshtim me nenin 11 të Ligjit, për shkak se në rastin konkret NPK UJËSJELLËSI Koçan ka dorëzuar Kontratë për furnizim me sasi uji gjeotermal, të lidhur me Shoqërinë për tregti dhe prodhim AGRO-TREF SHPK Koçan, në të cilën ka futur dispozitën e nenit 3 paragrafi (3), duke shfrytëzuar pozitën e saj dominuese dhe duke u përjashtuar nga përgjegjësia për dëmin eventual të shkaktuar te përdoruesi në rast të ndërprerjes dhe shkëputjes nga sistemi i furnizimit me energji elektrike, me ç’rast kushtëzon lidhjen e kontratës me pranimin e detyrimeve shtesë të cilat, nga natyra e tyre apo sipas zakoneve tregtare, nuk janë të lidhura me objektin e kontratës për furnizim me sasi uji gjeotermal.

Sipas nenit 11 paragrafi (1) dhe (2) të Ligjit:

(1) Ndalohet çdo abuzim me pozitën dominuese nga një apo më shumë ndërmarrje në tregun përkatës apo në një pjesë të tij thelbësore.

(2) Abuzimi nga paragrafi (1) i këtij neni ekziston veçanërisht në rastet e:

- 1) nënshtimit direkt apo indirekt të çmimeve jo të drejta të blerjes apo shitjes ose kushteve të tjera jo të drejta tregtare;
- 2) kufizimit të prodhimit, tregjeve ose zhvillimit teknik në dëm të konsumatorëve;

- 3) zbatimit të kushteve të ndryshme për veprime juridike të njëjta apo të ngjashme me partnerë të tjerë tregtarë, me ç'rast ata vendosen në pozitë më pak të favorshme konkurruese;
- 4) refuzimit të pajustificuar për të tregtuar ose nxitjes dhe kërkesës nga ndërmarrjet apo shoqatat e ndërmarrjeve të mos blejnë apo të mos shesin mallra dhe/ose shërbime një ndërmarrjeje të caktuar, me qëllim që në mënyrë jo të ndershme t'i shkaktohet dëm asaj ndërmarrjeje;
- 5) refuzimit të pajustificuar për t'i mundësuar qasje në rrjetin e vet ose objekte të tjera infrastrukturore të një ndërmarrjeje tjetër për kompensim adekuat, nëse pa këtë shfrytëzim të përbashkët, ndërmarrja tjetër, për arsye juridike ose faktike, pengohet të veprojë si konkurruese në një treg përkatës të caktuar.

Sipas nenit 59 të Ligjit:

(1) Komisioni për Vendimmarrje për Kundërvajtje, ndërmarrjes, respektivisht shoqatës së ndërmarrjeve, me vendim do t'i shqiptojë gjobë në vlerë deri në 10% të vlerës së të ardhurave vjetore të përgjithshme të realizuara në vitin e fundit afarist, të shprehur në vlerë absolute dhe nominale për të cilin ndërmarrja apo shoqata e ndërmarrjeve ka hartuar pasqyrë vjetore llogarie, nëse:

- 1) lidh kontratë të ndaluar ose në mënyrë tjetër merr pjesë në marrëveshje, vendim ose sjellje të harmonizuar me të cilat cenohet konkurrenca në kuptim të nenit 7 të këtij ligji;
- 2) kryen abuzim me pozitën dominuese në kuptim të nenit 11 të këtij ligji;
- 3) nuk vepron sipas vendimit të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës nga neni 51 i këtij ligji;
- 4) nuk vepron sipas vendimit të Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës nga neni 52 i këtij ligji;

Bazuar në të gjitha sa më sipër, nga analiza e të dhënave dhe dokumenteve të siguruara gjatë procedurës, KVK konstatoi se NPK UJËSJELLËSI Koçan, si ndërmarrje publike e themeluar me vendim të Këshillit të Komunës së Koçanit, e cila ka pozitë dominuese në tregun e furnizimit me ujë gjeotermal në territorin e Komunës së Koçanit, i ka dorëzuar Shoqërisë për tregti dhe prodhim AGRO-TREF SHPK Kontratë për furnizim me sasi uji gjeotermal nr.12-3571 të datës 18.10.2023, në të cilën kontratë ka futur dispozitë kufizuese në nenin 3 paragrafi (3), në të cilën dispozitë parashikohet se në rast të ndërprerjes dhe shkëputjes nga sistemi i furnizimit me energji elektrike për çfarëdo arsye të furnizuesi–dhënësi, ky nuk është përgjegjës për dëmin eventuale të shkaktuar të përdoruesi dhe në këtë mënyrë kushtëzon lidhjen e kontratës me pranimin e detyrimeve shtesë të cilat, nga natyra e tyre apo sipas zakoneve tregtare, nuk janë të lidhura me objektin e kontratës për furnizim me sasi uji gjeotermal, që paraqet kundërvajtje eventuale sipas nenit 59 paragrafi (1) pika 2), në lidhje me nenin 11 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Sipas nenit 59 paragrafi (1) pika 1) të Ligjit, KVK, ndërmarrjes, respektivisht shoqatës së ndërmarrjeve, me vendim do t'i shqiptojë gjobë në vlerë deri në 10% të vlerës së të ardhurave vjetore të përgjithshme të realizuara në vitin e fundit afarist, të shprehur në vlerë absolute dhe

nominale për të cilin ndërmarrja apo shoqata e ndërmarrjeve ka hartuar llogari vjetore, nëse kryen abuzim me pozitën dominuese.

Në përcaktimin e vlerës së gjobës, sipas nenit 64 të Ligjit, KVK do të marrë parasysh rëndësinë e kundërvajtjes, kohëzgjatjen e kundërvajtjes dhe shkallën e dëmtimit të konkurrencës dhe pasojat e shkaktuara nga kundërvajtja. KVK, gjatë matjes së gjobës, fillimisht përcakton shumën bazë të gjobës, e pastaj e përshtat të njëjtën, duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese ose rënduese. Shtesë, KVK mund ta rrisë shumën e gjobës për të arritur efektin dekurajues.

Sipas nenit 64 paragrafi (5) pika 2) KVK, si rrethanë lehtësuese në lëndë, merr faktin që NPK UJËSJELLËSI Koçan është ndërmarrje publike që ka ndërmarrë veprim në lidhje me kundërvajtjen e kryer, respektivisht dispozitën e kontestuar të Kontratës për furnizim me ujë gjeotermal, duke e fshirë dispozitën e nenit 3 paragrafi (3). Si provë për veprimin e NPK UJËSJELLËSI Koçan janë Anekset e dorëzuara të Kontratave për furnizim me ujë gjeotermal me konsumatorët, nga të cilat duket qartë se dispozitat e lartpërmendura të kontestuara janë fshirë dhe se në të ardhmen nuk do të kenë pasoja të dëmshme ndaj konsumatorëve.

NPK UJËSJELLËSI Koçan në vitin 2024 ka realizuar të ardhura të përgjithshme nga shitja e ujit të ngrohtë në vlerë prej 13.290.364,00 denarësh.

KVK konstatoi se vlera e gjobës që i shqiptohet NPK UJËSJELLËSI Koçan për kundërvajtjen e kryer sipas nenit 59 paragrafi 1) pika 1) të Ligjit është 10.000,00 denarë, që paraqet 0,07524% të vlerës së të ardhurave vjetore të përgjithshme të NPK UJËSJELLËSI Koçan të realizuara në vitin 2024, si viti i fundit afarist për të cilin e njëjta ka hartuar llogari vjetore.

Për shkak të lartpërmendurës u vendos si në dispozitivin e këtij aktvendimi.

Udhëzim juridik: Kundër këtij aktvendimi mund të paraqitet padi për fillimin e konfliktit administrativ para gjykatës kompetente brenda afatit prej tetë (8) ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi. Padia e pezullon ekzekutimin e aktvendimit.

KOMISIONI PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS
KOMISIONI PËR VENDIMMARRJE PËR KUNDËRVAJTJTE
KRYETAR
Mr. Борче Размоски